

RAPORTIMI I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË MEDIA

*- MANUAL PËR GAZETARËT E RINJ DHE
PËR STUDENTËT E GAZETARISË -*

**Rrapo Zguri
Ani Bajrami**

RAPORTIMI I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË MEDIA

*- Manual për gazetarët e rinj dhe
për studentët e gazetarisë -*

**RRAPO ZGURI
ANI BAJRAMI**



**FRIEDRICH
EBERT 
STIFTUNG**

Botues: **Friedrich-Ebert-Stiftung**
Office Tirana
Rr. Kajo Karafili
Nd-14, Hyrja 2, Kati 1, Kutia Postare 1418
Tiranë, Shqipëri

Autorë: **Rrapo Zguri**
Ani Bajrami

Redaktor: **Remzi Lani**

Dizajn dhe layout: **Brikena Berdo**

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

PËRMBAJTJA

1.	PSE KY MANUAL?	5
2.	ËSHTË KOHA E GAZETARISË KLIMATIKE	7
3.	PAK FJALË PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE SHKAQET E TYRE	9
4.	PASOJAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	14
4.1	<i>Rritja anormale e temperaturave</i>	14
4.2	<i>Mbingrohra e oqeaneve</i>	15
4.3	<i>Rritja e nivelit të deteve</i>	16
4.4	<i>Shkrirja e akujve dhe e akullnajave</i>	17
4.5	<i>Çrregullimet në ciklin hidrologjik</i>	19
4.6	<i>Fragmentimi dhe degradimi i ekosistemeve natyrore</i>	19
4.7	<i>Humbja e diversitetit biologjik</i>	21
4.8	<i>Përhapja në rritje e dëmtuesve dhe patogjenëve</i>	22
4.9	<i>Kërcënimi i trashëgimisë kulturore</i>	23
4.10	<i>Rritja e varfërisë dhe e priirjes për migrim</i>	25
5.	KRIZA KLIMATIKE: PËRPJEKJET PËR ZBUTJE DHE PËRSHTATJE	26
6.	PËRFSHIRJA E MEDIAVE NË ÇËSHTJET E KLIMËS – PAK HISTORI	30
7.	PRINCIPET QË DUHET TË UDHËHEQIN MEDIAT NË QASJEN E TYRE NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	35
8.	DHJETË REKOMANDIME PËR NJË GAZETARI KLIMATIKE MË TË MIRË	43
9.	MËNYRA EFKTIVE TË TË BËRIT GAZETARI KLIMATIKE	48
10.	SFIDAT E GAZETARISË KLIMATIKE SHQIPTARE	55
11.	BURIME TË DOBISHME PËR GAZETARËT E KLIMËS	58
11.1	<i>Burime Vendore</i>	58
11.2	<i>Burime ndërkombëtare</i>	58
	REFERENCA	60
	<i>Artikuj</i>	60
	<i>Raporte / manuale</i>	61

1

PSE KY MANUAL?

Për shekuj me radhë, situata klimatike e planetit tonë ka qenë përcaktuar nga faktorë dhe ekuilibra natyrorë. Ndryshimet klimatike zhvilloheshin brenda ligjeve të natyrës dhe ndiqnin rrjedhën e përcaktuar prej tyre. Por gjatë dekadave të fundit janë konstatuar një numër i konsiderueshëm ndryshimesh që vijnë si rezultat i veprimtarisë njerëzore. Duke u krijuar nga një forcë jashtë-natyrore siç janë për shembull industritë e mëdha emetuese të dioksidit të karbonit, këto ndryshime janë të panatyrshme dhe të pandodhura më parë. Dhe njëherësh me pasoja të paparashikueshme.

Në librin e tij të shkurtër mbi ngrohjen globale, të botuar në vitin 1991, gazetari i mirënjohur mjedisor amerikan Endrju Revkin shkroi: *“Ne kemi hyrë në një epokë, që mund të konsiderohet si epoka e Antrocentit. Në fund të fundit, kjo epokë gjeologjike ka vulën tonë”*.

Në komunitetin shkencor, nisi të përdorej termi “Antropocen” për të emërtuar epokën në të cilën po jetojmë, duke shënuar kalimin nga epoka 12 mijë vjeçare e Holocenit në epokën e Antropocenit ose në Epokën e Njeriut. Përdorimi i këtij termi nxjerr në pah rolin dhe rëndësinë që ka njeriu në ndryshimin e ekosistemeve natyrore por dhe përgjegjësinë e tij për të përmirësuar realitetin klimatik.

Duke sendërtuar fenomene të dekadave të fundit, ndryshimet klimatike përbëjnë një fushë relativisht të re të dijes dhe të

veprimtarisë njerëzore. Ato janë një fushë e re raportimi edhe për mediat. Në këtë kontekst, ky manual vjen si një udhërrëfyes për ata që do të donin të përfshiheshin në raportimin e krizës klimatike dhe të problemeve që lidhen me të.

Janë disa faktorë që e bëjnë urgjent një botim të tillë në gjuhën shqipe:

Së pari, domosdoshmëria e ndërhyrjes së menjëhershme për të minimizuar pasojat katastrofike të ndryshimeve klimatike.

Së dyti, mungesa e teksteve apo e doracakëve në këtë fushë.

Së treti, mungesa e njohurive dhe e profilizimit në gazetarinë klimatike.

Së katërti, nevoja për standartizimin dhe krijimin e paketës të mjeteve profesionale në këtë drejtim.

Ky manual iu vjen në ndihmë edhe redaktorëve apo botuesve të mediave, për të patur një qasje më përfshirëse ndaj temave dhe çështjeve që lidhen me klimën. Por ai mund t'ju shërbejë edhe blogerëve apo aktivistëve të fushës klimatike për të ndërtuar fushata komunikimi profesionale apo për të krijuar përmbajtje cilësore mediatike.

Krahas botimit të këtij manuali, për shoqërinë shqiptare është urgjente edhe angazhimi më i gjerë i mediave në këtë kauzë të re dhe shumë të rëndësishme të njerëzimit duke krijuar hapësirë më të madhe mediatike për problematikat që lidhen me klimën.

2

ËSHTË KOHA E GAZETARISË KLIMATIKE

Komunikimi i ndryshimeve klimatike dhe i pasojave të tyre nuk mund të jetë kurrë i plotë pa mediat. Në realitetin e sotëm të mbingarkesës me informacion, hapësira për informacionin e një fushe specifike sa vjen e ngushtohet, nëse kjo gjë lihet në dorë të spontanitetit. Pavarësisht nga neglizhenca e treguar deri më tani nga mediat për krizën klimatike, zhvillimet e sotme janë kaq serioze dhe dramatike sa që kërkojnë një ndryshim rrënjësor të sjelljes dhe të politikës editoriale të tyre në raport me këto zhvillime. Dy gjëra janë njëherazi imperative: nga njëra anë, është e domosdoshme që kriza klimatike të zërë vendin e duhur në media, dhe nga ana tjetër, çdo lloj iniciative apo lëvizje për ndryshim në fushën e ndryshimeve klimatike duhet të konsiderojë dhe të përfshijë domosdoshmërisht edhe mediat si kanal i pazëvendësueshëm komunikimi.

Në praktikën e vendeve perëndimore, çështjet e klimës jo vetëm që e kanë gjetur një vend në media, por ato kanë hedhur themelet edhe për një lloj të ri gazetarie që njihet me emrin “*gazetaria klimatike*”. Kjo lloj gazetarie fokusohet në:

- ⊙ Informimin e publikut me ngjarjet apo zhvillimet më të fundit nga fusha e ndryshimeve klimatike. Ngjarjet apo zhvillimet e kësaj fushe nuk mungojnë; ajo që kërkohet është vullneti pozitiv i drejtuesve të mediave, redaktorëve dhe i gazetarëve për t’i përfshirë në axhendat e tyre të lajmeve.

- ⊙ Gjenerimin e një debati publik lidhur me çështjen e ndryshimeve klimatike dhe pasojave të tyre. Deri më sot debati në këtë fushë ka qenë i kufizuar në rrethin e specialistëve apo disa OJF-ve të fushës.
- ⊙ Promovimin e lëvizjeve apo iniciativave klimatike në rradhët e publikut të gjerë. Ka eksperiencë pozitive të cilat mbeten në hije kur nuk përcillen apo mbështeten nga mediat.
- ⊙ Nxitjen e ndërmarrjeve investiguese për të hedhur dritë mbi zhvillime të errëta apo korruptive në fushën e investimeve apo veprimtarive që çenojnë klimën.
- ⊙ Nxitjen dhe promovimin e legjislacionit dhe të politikave që synojnë përshtatjen dhe minimizimin e pasojave.
- ⊙ Krijimin e sinergjisë mes të gjithë aktorëve të shoqërisë që janë të përfshirë në çështjet klimatike.
- ⊙ Edukimin e njerëzve lidhur me atë që po ndodh, dhe me pasojat e saj, dhe ndërgjegjësimin e tyre për të marrë pjesë në çdo lloj veprimtarie që përmirëson kushtet klimatike në mjedisin ku jetojnë.

Gazetaria klimatike zhvillohet në pranëndodhje me dy fusha të tjera, siç janë *gazetaria mjedisore* dhe *gazetaria e motit*. Duke patur parasysh faktin që fusha e mjedisit dhe ajo e motit kanë mjaft pikëtakime të përbashkëta me klimën si dhe reflektojnë marrëdhënie varësie apo shkak/pasoje mes tyre, shumë standarte të njërit lloj shërbejnë edhe për llojin tjetër të gazetarisë. Këto tre lloje gazetarie nuk e përjashtojnë, përkundrazi e plotësojnë njëra-tjetrën duke shtuar secila pjesën e vet në raportimin për ekosistemin klimatiko/mjedisor.

3

PAK FJALË PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE SHKAQET E TYRE

Klima nënkupton bashkësinë e kushteve meteorologjike dhe mjedisore që karakterizojnë një rajon të caktuar gjeografik, për një periudhë kohe relativisht të gjatë. Çdo rajon i Tokës karakterizohet nga një klimë e caktuar, e cila përcaktohet nga sistemi klimatik i një rajoni. Sistemet klimatike janë sisteme dinamike dhe elementët përbërës të tyre, si atmosfera dhe përbërja e saj, e cila ka një rol përcaktues në formimin e klimës të një rajoni, ndryshojnë për shkaqe natyrore dhe për shkaqe që lidhen me aktivitetet njerëzore.



Photo: Eliud Gil Samaniedo, 2019

Ndryshimet klimatike janë përcaktuar si një ndryshim global i klimës së Tokës. Ndryshimi i klimës presupozon variacionet në nivel global, për një periudhë kohe relativisht të gjatë, të disa prej parametrave klimatikë si temperatura e ajrit, niveli i rreshjeve, temperatura e deteve dhe oqeaneve dhe pasojat që ato kanë në ekosisteme. Referuar shpejtësisë së ndryshimit në dhjetëvjeçarët e fundit, ndryshimi i klimës është përcaktuar si një ndryshim në modelet klimatike që përcaktojnë klimën lokale, rajonale dhe globale të Tokës dhe që i atribuohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, aktiviteteve njerëzore. Shumica e shkencëtarëve janë dakort me faktin se njeriu është në epiqendër dhe përgjegjësi kryesor për ngrohjen globale.

“Ndryshimet klimatike janë sfida më e madhe dhe më e rëndësishme e njerëzimit në shekullin të 21-të”

Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2018

Vlen të theksojmë se ekziston një ndryshim mes dy koncepteve që hasen më shpesh në media siç janë ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike. Kur shkencëtarët flasin për *ngrohje globale*, i referohen rritjes së temperaturës në Tokë, si rezultat i pjesës së shtuar të efektit serë, pasojë e aktiviteteve njerëzore. Ndërsa me *ndryshime klimatike*, shkencëtarët kanë parasysh ato pasoja në klimën e tokës, që rrjedhin prej ngrohjes globale. Thënë ndryshe, ngrohja globale po ndryshon sistemet klimatike të Tokës.

Çfarë kuptojmë me *efekt serë*? Efekti serë ka ekzistuar që me krijimin e atmosferës në planetin tonë. Rolin kryesor në efektin serë e luan

prania në atmosferë e disa gazeve, që njihen ndryshe si gaze serë, ku përfshihen dioksidi i karbonit (CO₂), oksidet e azotit (NO_x), metani (CH₄), SF₆, HFCs dhe PFCS. Këto gaze kapin nxehtësinë në shtresat e poshtme të atmosferës, duke krijuar një efekt të ngjashëm me atë që ndodh në një serë: krijojnë një mjedis më të ngrohtë, të përshtatshëm për Jetën në planetin tonë.

Përqëndrimi i lartë i dioksidit të karbonit në atmosferë shkakton çrregullime në ciklin natyror të temperaturës duke shkaktuar ngrohjen globale. Ndër burimet e tjera që çlirojnë një sasi të madhe të dioksidit të karbonit në atmosferë përfshihen dhe ato që vijnë prej shkatërrimit të biomasës (p.sh shkatërrimi aktual i pyjeve tropikalë për t'i kthyer në toka bujqësore dhe kullota). Le të rreshtojmë disa fakte:

- ⊙ Për shkak se çlirohet më shumë CO₂ në atmosferë se ç'mund të "heqin" proceset natyrore, sasia e tij sa vjen e rritet.
- ⊙ Ritmi i rritjes së sasisë së CO₂ në këto 60 vitet e fundit është 100 herë më i shpejtë krahasuar me rritjen natyrore të tij.
- ⊙ Sasia e CO₂ në atmosferë në vitin 2021 arriti 414.72 ppm.
- ⊙ CO₂ është kontribuesi kryesor i nxehtësisë (66%), metani është në masën 16% dhe CFCs në masën 7.6%.
- ⊙ Deri në vitin 2030 parashikohet se pavarësisht përpjekjeve për të ulur sasinë e CO₂ në atmosferë, temperatura globale do të rritet me të paktën 1.5 gradë Celsius.

Siç dihet, djegia e lëndëve fosile shoqërohet me çlirimin në sasi të mëdha të gazeve serë. Në lëndët fosile përfshihen qymyrguri, gazi natyror apo nafta. Që prej periudhës para-industriale (1850-1900), duke kulmuar në gjysmën e shekullit të 20-të (pas Luftës së Dytë

Botërore), aktivitetet njerëzore, kryesisht djegia e lëndëve fosile, kanë rritur ndjeshëm, gati në mënyrë të pakthyeshme, temperaturat në sipërfaqen e globit.

“Përqendrimi i lartë i dioksidit të karbonit në atmosferë shkakton çrregullime në ciklin natyror të temperaturës duke shkaktuar ngrohjen globale”

Emetuesit më të mëdhenj të CO₂ nga viti 1975 deri në vitin 2020 janë SHBA, Kina, Rusia, Gjermania dhe Britania e Madhe. Megjithëse Europa zë më pak se 10% të të gjithë Botës dhe popullata e saj përbën rreth 15% e popullatës botërore, vendet evropiane ndikojnë fuqishëm në shkarkimet globale të gazeve serë dhe substancave të tjera, të cilat sjellin ndryshime të mëdha në atmosferë. Prej vitit 1988, kompanitë *ExxonMobil*, *Shell*, *British Petroleum* dhe *Chevron* janë ndër emetuesit më të mëdhenj të dioksidit të karbonit.

Kjo ka sjellë situatën që emetuesit më të mëdhenj në botë të CO₂ të jenë edhe shkaktarët e shkatërrimit të ekosistemeve natyrore dhe të një pjese të trashëgimisë kulturore të shoqërive njerëzore në rajone të tjera të globit. Shkarkimet prej aktiviteteve njerëzore të dioksidit të karbonit janë përgjegjëse për shumë efekte ose pasoja të tjera, të cilat do t'i përmendim më poshtë.

Në kushtet kur kriza klimatike përfaqëson edhe një problem thelbësisht social, advokimi për mbrojtjen e pjestarëve të shoqërive që preken më shumë prej krizës klimatike, kërkon edhe angazhimin e mediave dhe të gazetarëve. Pabarazia klimatike, që i referohet faktit

se disa individë ose grupe individësh preken më shumë krahasuar me të tjerët prej krizës klimatike, konsiderohet sot një problem i rëndësishëm, së bashku me pabarazinë ekonomike.

Hendeku mes anëtarëve të shoqërisë apo shoqërive në mbarë botën, sa vjen e thellohet. Këtu kemi parasysh, individët që jetojnë në varfëri, kanë akses të kufizuar në shërbime sociale apo burime që lidhen me mbijetesën, fëmijët dhe të moshuarit, individët që vuajnë prej paragjytimeve, si grupe etnike të caktuara apo gratë etj.

“Politikat globale që synojnë uljen e temperaturave duhet të konceptohen të atilla që të zvogëlojnë pabarazinë”

Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2021

Nga ana tjetër, koncepti i drejtësisë klimatike, nuk i referohet vetëm faktit të gjithëpranuar se kriza klimatike prek njerëzit në mënyrë të pabarabartë, por nevojës për të advokuar për grupet e prekura, të drejtat e të cilëve jo vetëm çënohen por edhe nëpërkëmben prej politikave të padrejta ose për shkak të interesave financiare të korporatave të ndryshme, kryesisht të lidhura me industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të karburanteve fosile.

4

PASOJAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ndryshimet klimatike dhe pasojat e tyre janë dukuri konkrete, të verifikuara në terren apo të faktuara nga kërkimi shkencor. Si të tilla ato përbëjnë një objekt konkret edhe për gazetarinë. Cilat janë çështjet apo pasojat e ndryshimeve klimatike në të cilat duhet të përqendrohet edhe fokusi i raportimit të gazetarisë klimatike? Po rendisim më poshtë më kryesoret prej tyre:

4.1 Rritja anormale e temperaturave

Temperatura mesatare në sipërfaqen e Tokës është rritur rreth 0.7 gradë Celsius që prej fillimshekullit XX. Në vitin 2018, u llogaritën rreth 315 katastrofa natyrore që prekën 68.5 milionë njerëz dhe dëmi ekonomik për pasojë, arriti në 131 miliardë dollarë. Rreth 93% e katastrofave natyrore i referohen stuhive, përmbytjeve, zjarreve dhe thatësirave.

Të gjithë jemi dëshmitarë se frekuenca dhe kohëzgjatja e periudhave të thatësirave apo valëve të të nxehtit është rritur. Po ashtu, përmbytjet e shkaktuara prej shirave të rrëmbyeshëm e të paparashikueshëm. Ballkani konsiderohet një nga rajonet që do të vuajë më shumë krizën klimatike. Sektori më i prekur do të jetë ai bujqësor. Pritet të ketë rënie të prodhimit bujqësor shoqëruar me erozionin.

Ndërkaq, rreziku i ndotjes së ujit së bashku me humbjen e burimeve ujore përbën një shqetësim tjetër të madh. Ndërtimi i HEC-ve në vend nuk konsiderohet një strategji e zgjuar në terma afatgjatë ekonomikë. Po ashtu, prej degradimit dhe fragmentimit të eksosistemeve, po rrezikohet diversiteti biologjik në vend.

Këto po ndodhin, por në të ardhmen pritet rritja e ritmit të ndodhjes së këtyre ngjarjeve të padëshirueshme dhe me kosto të lartë ekonomike dhe njerëzore. Nuk duhet të harrojmë se shtimi i valëve të të nxehtit në qytetet tona, sidomos ato të mbipopulluara dhe të gjendura në shtjellën e një kaosi urban pas rënies së komunizmit, rrezikon shëndetin e njerëzve. Më të rrezikuarit janë të moshuarit, gratë shtatzëna dhe fëmijët.

4.2 Mbingrohja e oqeaneve

Oqeanet mbulojnë rreth 70% të sipërfaqes së Tokës dhe kanë një aftësi të madhe përthithëse të nxehtësisë. Në kushtet e ngrohjes globale prej çlirimit të gazeve serë, oqeanet kanë përthithur rreth 90% të nxehtësisë. Pasojat përfshijnë rritjen e nivelit të deteve, shkrirjen e përsheptuar të masës akullnajore dhe acidifikimin.

“Më shumë se 1 miliardë njerëz në Botë varen prej oqeaneve për të përftuar proteinat e nevojshme për ushqim”

CO₂ osedioksidi i karbonit shpërbëhet në ujë dhe gjatë bashkëveprimit me molekulat e ujit, prodhon acid karbonik (HCO₃) dhe ullet pH i oqeanit (rritet aciditeti). Që prej fillimit të Revolucionit Industrial, pH i sipërfaqes së oqeanit është ulur nga 8.21 në 8.10. Kjo ulje e pH quhet acidifikim. Acidifikimi i oqeanit pritet të ndikojë në llojet që jetojnë aty, në shkallë të ndryshme. Tejet shqetësues është fakti se më shumë se 1 miliardë njerëz në Botë, mbështeten tek oqeanet për të përftuar proteinat e nevojshme për ushqim.

4.3 Rritja e nivelit të deteve

Rritja e nivelit të deteve konsiderohet një ndër pasojat kryesore të ndryshimeve klimatike. Kjo rritje është rezultat i:

- ⊙ Bymimit termal të ujit të detit
- ⊙ Shkrirjes së akullit në male
- ⊙ Shkrirjes së kapsulave akullnajore të shumë ishujve, si ai i Groenlandës
- ⊙ Ndryshimet e akullnajave dhe mbështjelljes akullnajore që vesh Antarktidën

Sipas parashikimeve, prej vitit 2050 deri me 2100 rritja mendohet se do të jetë me rreth 50 cm. Pasojat e ndikimit në mjedis do të jenë të shumta: përmbytje të përhershme të zonave në afërsi të bregut dhe tokave bujqësore, erozion, ndikime në rezervat e ujrave nëntokësore dhe sipërfaqësore, etj.



Burimi: EcoAlbania

Në Shqipëri po ndodh erozioni i lumenjve dhe ai detar. Sipas vlerësimeve, ka rezultuar se 20% e tokës bujqësore ka një shkallë të lartë rreziku prej dukurive erozive. Gjithashtu, avancimi i tokës drejt detit ose erozioni detar, i përshpejtuar nga shpyllëzimet dhe urbanizimi, u vlerësua përkatësisht, në Durrës dhe në Lezhë, në masën 17% dhe 20%.

4.4 Shkrirja e akujve dhe e akullnajave

Në paragrafin hyrës të veprës së mirënjohur “100 vjet vetmi” të shkrimtarit kolumbian G.G. Marquez, personazhi kryesor, Aureliano Buendia, gjendur përballë togës së pushkatimit, i kujtohet se një mbasdite të largët, babai i tij e kishte çuar të zbulonte akullin.

Për ata që nuk e kanë lexuar këtë libër të mrekullueshëm, me siguri i kujtohen fotot në media të arinjve polarë, që mbijetojnë në një mjedis pothuaj të shkatërruar. Shkrirja e akullit dhe akullnajave është tashmë realitet. Ne e dimë se çlirimi i gazeve serë nga aktivitetet njerëzore, rriti përqëndrimin e tyre në atmosferë. Rrjedhimisht, edhe temperaturat u rritën, sidomos në pole.



Burimi: Green Matters

Llogaritet se rreth 95% e akujve në Arktik nuk janë më. Deri në vitin 2040, mendohet se nuk do të ketë më akull në Arktik. Ndërkaq, në fund të vitit 2100, sipas projeksioneve, 1/3 e akullnajave të mbetura, do të shkrijnë. Shkrirja e masës akullnajore së Groenlandës dhe Antarktidës po kontribuon në rritjen e nivelit të deteve.

Ashtu si Aureliano Buendia, të gjendur përballë realitetit klimatik, ne do të na kujtohen hapësirat e dikurshme të mbuluara nga akulli.

4.5 Çrregullimet në ciklin hidrologjik

Midis ndikimeve më të mëdha që mund të sjellin ndryshimet klimatike është cikli hidrologjik. Shtimi i ngjarjeve ekstreme si përmbytjet apo thatësitat e tejzgjatura, mund të shkaktojnë rritjen e shpeshtësisë së katastrofave, ndërsa ndryshimet që mund të ndikojnë mbi rreshjet, avullimin dhe lagështirën e tokës, do të ndryshojnë fuqishëm praktikatat bujqësore dhe sistemet e menaxhimit të ujit, si dhe do të çojnë në degradimin e tokës.

“Përmbytjet do të jenë më të shpeshta në vjeshtë dhe dimër dhe sasia e përgjithshme e dëmtimeve nga përmbytjet, do të vijë duke u rritur”

Modeli stinor i rënies së shirave do të ndryshojë, sidomos në ujëmbledhësa apo në zona të ndërmjetme. Rënia e shirave në dimër do të rritet ndjeshëm, ndërkohë që në verë do të ulet. Përmbytjet do të jenë më të shpeshta në vjeshtë dhe dimër, dhe sasia e përgjithshme e dëmtimeve nga përmbytjet, do të vijë duke u rritur.

4.6 Fragmentimi dhe degradimi i ekosistemeve natyrore

Çrregullimet e ciklit hidrologjik, me ndryshimet e reshjeve dhe lagështisë do të ndikojnë në shtimin e erozionit si dhe ndryshime në shpejtësinë e riciklimit të lëndëve organike. Kjo, në fakt, do të

ndikojë në produktivitetin e bimëve, konkurrencës midis llojeve dhe ndryshime ne biodiversitet.



Burimi: Albanian Ornithological Society

Kjo lidhje e ndërlikuar mes faktorëve të ndryshëm, së bashku me pasiguritë për ujin, e bën më të vështirë parashikimin e ndryshimeve në ekosistemet natyrore, si rezultat i vendosjes së ekuilibrave të rinj natyrore. Për më tepër, ndryshimet mund të ndodhin aq shpejt, sa bimët nuk do të kenë kohë të shtrihen në zona të reja (përmes mekanizmave natyrore të përhapjes).

Ndryshimet klimatike do të ndikojnë në ekosisteme dhe në bujqësi pasi temperaturat dhe procesi avullim /rreshje do të prekin zona të mëdha biogeografike (p.sh Mesdheun).

Ndikimi i madh i ndryshimeve klimatike në bujqësi mund të ketë pasoja dramatike pasi do të zvogëlojë prodhimin bujqësor. Kjo pasi bimët do të kenë një reagim të ndryshëm ndaj këtyre ndryshimeve. Për shembull, të lashtat kryesore si misri dhe kallami i sheqerit mund të kenë ulje të rendimentit të tyre sepse këto ndryshime, do të ndikojnë p.sh në rritjen e barërave të këqija.

4.7 Humbja e diversitetit biologjik

Një efekt i konsiderueshëm i ndryshimeve klimatike që ndikon në humbjen e biodiversitetit është rritja e intensitetit dhe frekuencës së zjarreve, stuhive me shira të rrëmbyeshëm dhe thatësirave. Ka disa fakte shqetësuese që provojnë humbjen e diversitetit biologjik:

- ⊙ Që prej shekullit XVI rreth 680 lloje vertebrorësh janë zhdukur.
- ⊙ Më shumë se 41.000 lloje kafshësh rrezikojnë të zhduken (41% e amfibëve, 27% e gjitarëve dhe 13% e shpendëve të njohur).
- ⊙ Ndotja detare është rritur me 10 herë që prej vitit 1980 dhe ka prekur rreth 267 lloje detare (86% breshka detare, 44% e zogjve detare dhe 43% e gjitarëve detarë).
- ⊙ Nga viti 1990 deri në vitin 2020 rreth 420 milionë hektarë pyje (më së shumti pyje tropikalë) janë shkatërruar.

Së fundmi, raporti i Gjendjes së Shpendëve Botërorë paralajmëroi se 1 në 8 shpendë rrezikon zhdukjen. Reduktimi i numrit të llojeve, ku përfshihen edhe polenizuesit si bletët, shpendët apo insekte të ndryshme, rrezikon integritetin e ekosistemeve natyrore dhe shoqërive njerëzore.

“Diversiteti biologjik është pjesë e identitetit tonë kulturor, ofron ngushëllim shpirtëror dhe luan një rol të rëndësishëm në gjendjen tonë mendore dhe fizike”

Komisioni Europian, 2008

Në humbjen e diversitetit të botës së gjallë ndikojnë dhe modelet e konsumit të sotme, por më e rëndësishmja, mungesa e politikave në dobi të ruajtjes dhe mbrojtjes së tij. Në vendin tonë, disa nga faktorët që rrezikojnë diversitetin biologjik janë tjetërsimi i habitateve, ndotja e lumenjve, zjarret në pyje, urbanizimi dhe gjuetia e paligjshme.

4.8 Përhapja në rritje e dëmtuesve dhe patogjenëve

Ndryshimet klimatike ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të vektorëve të patogjenëve, si insektet dhe zogjtë. Nga ana tjetër, shpyllëzimi për të siguruar tokë bujqësore dhe për ndërtimin e fermave, ka krijuar kushtet për kontakt më të shpeshtë mes njerëzve dhe patogjenëve.

Këto veprimtari, kombinuar me përmirësimin e mjeteve të transportit ose aftësinë për të përshkuar vende të largëta në një kohë të shkurtër, kanë ndikuar në ritmet dhe shpejtësinë e përcjelljes së patogjenëve, rrjedhimisht, shfaqjen dhe rishfaqjen e sëmundjeve në popullatat njerëzore. Për shembull, shpërthimi i kolerës, malaries apo diariesë ndikohen prej ndryshimeve klimatike. Jeta e miliona njerëzve që jetojnë në zonat tropikale, do të vihet në rrezik. Sipas OBSH (2017) si pasojë e ndryshimeve klimatike, shëndeti i miliona njerëzve do të kërcënohet prej këtyre faktorëve:

- ⊙ Efektet direkte dhe të tërthorta të ngrohjes globale
- ⊙ Problemet në ekosistemet detare dhe tokësore
- ⊙ Humbja e biodiversitetit
- ⊙ Ndryshimet e vërejtura në ciklin hidrologjik

Shqetësues është fakti se dhe nëse Bota nuk ngrohet me 2 gradë Celsius, përhapja e viruseve do të ndodhë pavarësisht, sidomos në vende me popullsi të madhe, si Azia dhe Afrika. Në këto kushte, bashkëpunimi horizontal dhe vertikal brenda shtetit dhe mes shteteve mund të ndihmojë në parandalimin e situatës së pritshme.

4.9 Kërcënimi i trashëgimisë kulturore

Njerëzit jetojnë në dy lloje mjedisesh: natyrore dhe sociale. Ky i fundit, përbëhet nga marrëdhëniet dhe bashkëveprimet që krijojnë norma, vlera, besime dhe perceptime të caktuara, të cilat përkthehen në sjellje.

Kriza klimatike nuk prek vetëm mjedisin natyror por dhe produktet kulturore ose kulturën materiale të një shoqërie, anëtarët e së cilës jetojnë në një mjedis të caktuar. Trashëgimia kulturore përfshin tërësinë e kulturës materiale dhe jo materiale, të trashëguar brez pas brezi nga anëtarët e shoqërisë.

“Gazetarët e klimës mund të kontribuojnë edhe si mbrojtës dhe advokues të çështjeve që lidhen me trashëgiminë kulturore”

Fatkeqësisht, në kushtet kur frekuenca dhe intensiteti i thatësirave dhe rreshjeve që shkaktojnë përmytje është rritur, trashëgimia kulturore është në rrezik. Njerëzit, si mbartës të kësaj trashëgimie, që vuajnë nga marxhinalizimi apo që jetojnë në zona të izoluar (p.sh vendasit që jetojnë në pyjet e Amazonës) rrezikohen po ashtu. Dijet e akumuluar ndërkohë prej tyre, ku përfshihen dhe ato dije që lidhen me natyrën, dhe që mund të shërbejnë për t'u përshtatur me krizën klimatike, duhen ruajtur, si pjesë e fondit të përbashkët kulturor botëror. Kjo është nga arsyt, që gazetarët e klimës mund të kontribuojnë edhe si mbrojtës dhe advokues të çështjeve që lidhen me trashëgiminë kulturore.



Burimi: Albanian profile

4.10 Rritja e varfërisë dhe e prirjes për migrim

Pranohet gjerësisht mes studiuesve se ekziston një lidhje mes krizës klimatike dhe rritjes së varfërisë. Thatësitrat, përmytjet dhe valët e të nxehtit prekin lagje të varfra, përmbysin toka bujqësore, njerëzit që punojnë në ambient të hapur etj. Më të prekurit, janë njerëzit me të ardhura të ulta ekonomike, situata ekonomike e të cilëve vështirësohet edhe më, në kushtet e krizës klimatike.

Nga ana tjetër, zhvendosja e njerëzve si pasojë e krizës klimatike llogaritet se në vitet 2010-2019 arriti në shifrën 23.1 milionë. Një shembull klasik është ai i Sirisë. Shpërthimi i luftës civile në vitin 2011 i detyrohet disa faktorëve. Ndër to, thatësitrat prej të paktën gjashtë vitesh që pushtuan vendin, shkaktuan zhvendosjen e njerëzve në qytet. Për shkak të stresit social dhe gjendjes jo të mirë ekonomike në qytete dhe mbipopullimit, kombinuar me pakënaqësitë ndaj qeverisjes, nisën konfliktet, deri në shpërthimin e luftës civile, që shkaktoi dhe emigracionin masiv.

Që prej vitit 2011, llogaritet se kanë emigruar më shumë se 6.8 milionë sirianë. Në mënyrë direkte apo të tërthortë, thatësitrat ndikuan në shpërthimin e luftës civile dhe migrimin masiv të popullsisë. Ky shembull na shërben të kuptojmë, se si gazetarë, njohja e faktorëve klimatikë, jo vetëm ekonomikë apo politikë, na ndihmon të analizojmë dhe interpretojmë ngjarje të caktuara në një dritë të re faktesh.

5

KRIZA KLIMATIKE: PËRPJEKJET PËR ZBUTJE DHE PËRSHTATJE

Masat që janë marrë dhe po ndërmerren në të gjithë botën në lidhje me ndryshimet klimatike përqendrohen në dy objektiva: zbutja dhe përshtatja. Zbutja lidhet ngushtë me zgjidhjen e shkaqeve të ngrohjes globale ndërsa përshtatja me ndryshimet klimatike ka të bëjë me uljen e rrezeve ose zvogëlimin e pasojave të krizës klimatike. Është e qartë se përmirësimi i teknologjive së bashku me marrjen sa më herët të masave për t'u përshtatur me realitetin klimatik, duhet të jenë paralele.

Një pjesë e madhe e strategjive për zbutjen e krizës klimatike lidhet me përdorimin e teknologjive që synojnë “kapjen” e CO₂ ose përpjekjet për dekarbonizim. Këto teknologji, janë në fillimet e tyre dhe kanë nevojë të zhvillohen dhe të testohen. Masat për zbutjen janë të lidhura dhe me përpjekjet për kalimin ose tranzicionin drejt energjisë së gjelbër. Gjithashtu, në të ardhmen pritet një qasje e re politike për këtë tip tranzicioni socio-teknik. Përsheptimi i reduktimit të shkarkimeve në këtë dekadë është thelbësor. Me qëllim arritjen e objektivave të vendosura në Konferencën për Klimën që prodhoi Marrëveshjen e Parisit (COP21 në 2015), për të mbajtur temperaturën nën 1,5 gradë Celsius nëpërmjet strategjive zbutëse, qeveritë synojnë të marrin masa për të ulur shkarkimet e gazeve serë me 45% nga nivelet e vitit 2010 deri në vitin 2030 dhe të arrijmë net zero shkarkime deri në vitin 2050 (IPCC, 2016).

Në rastin e Shqipërisë, bazuar në Indeksin e Performancës Mjedisore, një ndër nënkategoritë ku vendi ynë ka performuar më pak ka qenë adresimi i politikave të duhura për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Sipas raportit, ne renditemi në vendin e 62-të, nga 180 shtete të marra në studim, sa i përket performancës së mbrojtjes së mjedisit.

Përdorimi i energjisë në mënyrë eficiente për uljen e emëtimit të gazeve serë në industri, ndërtesa, transport etj. është një nga mënyrat. Këto masa varen nga vullneti politik, rrethanat ekonomike dhe ato teknologjike të një vendi të caktuar.

“Përmirësimi i teknologjive sëbashku me marrjen sa më herët të masave për tu përshtatur me realitetin klimatik duhet jenë paralele”

Nga ana tjetër, përshtatja me krizën klimatike përfshin ndryshime në nivel ekologjik, social, politik, ekonomik dhe të sjelljeve. Ajo i referohet ndryshimeve në procese, praktika dhe struktura si përgjigje ndaj dëmeve të mundshme prej krizës klimatike. Këto ndryshime mund të përfshijnë infrastrukturën. Për shembull, valët e të nxehtit që përfshinë këtë vit Anglinë, dëmtuan infrastrukturën, si sistemet e transportit hekurudhor.

Siç pohuam më lart, masat përshtatëse kanë si qëllim parandalimin ose zvogëlimin e pasojave të krizës klimatike dhe me shpresë, të jenë të dobishme. Sa më herët të implementohen, aq më shumë shpëtojnë jetë njerëzish! Për shembull, një nga masat që duhet marrë në vendin tonë kundër valëve të të nxehtit është mbjellja e pemëve në zonat urbane dhe vënia fre e urbanizimit të skajshëm.

Një masë e domosdoshme përshtatëse ishte zgjatja e Moratoriumit të Gjetisë edhe për pesë vite. Qëllimi i saj është ruajtja e biodiversitetit ose diversitetit biologjik vendas. Nga ana tjetër, zgjerimi i zonave të mbrojtura, do t'i shërbejë jo vetëm ruajtjes së integritetit të ekosistemeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore por edhe zvogëlimit të pasojave të krizës klimatike në vendin tonë.

Gjithashtu, në shembullin e disa qyteteve, hapja e zyrave për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave të krizës klimatike në bashkitë vendase me rrezik të lartë, do të ndihmonte qytetarët, sidomos shtresat në nevojë, të përballëshin si duhet me to.



Burimi: United Nation News

Deri më sot, reagimi i qeverive dhe i aktorëve me pushtet në dobi të përmirësimit të krizës klimatike në mbarë globin nuk ka qenë i kënaqshëm. Në disa raste, vullneti politik i është nënshtuar presionit të korporatave të nxjerrjes dhe përpunimit të karburanteve fosile të cilët janë shkaktarët kryesorë të krizës dhe që ende zgjedhin fitimin përkundër shpëtimit të globit nga kjo fatkeqësi e paralajmëruar.

Prej hetimit të dokumentave të kompanive të karburanteve fosile që prej viteve 1970, rezultoi se krerët e kompanive ishin në dijeni të pasojave prej shtimit të dioksidit të karbonit në atmosferë, por vendosën të nxisnin dyshime tek publiku, përmes financimeve për kërkim pseudo-shkencor. Bazuar në këto pseudo-kërkime gazetarët dhe media të ndryshme u bënë aktorë ose viktima të përhapjes së informacioneve të rreme lidhur me shkaqet dhe pasojat e krizës klimatike.

6

PËRFSHIRJA E MEDIAVE NË ÇËSHTJET E KLIMËS – PAK HISTORI

Kërkimet mbi ndikimin e aktiviteteve njerëzore në ndryshimet klimatike janë realizuar qysh në shekullin e 18-të. Një shekull më pas, në vitin 1896, kimisti suedez Svante Arrhenius deklaroi se çlirimi i CO₂ në atmosferë mund të çojë në rritje të temperaturës së ajrit në Tokë. Pasqyrimi i këtyre zhvillimeve dhe deklaratave përbëjnë nga shembujt e parë në histori të përfshirjes dhe angazhimit të mediave në çështjet e ndryshimeve klimatike.

Shqetësimet e publikut në lidhje me çështjet e mjedisit janë shfaqur në media të paktën që prej mesit të shekullit të 19-të edhe në një prej qyteteve pioniere të epokës industriale siç është Londra. Në këtë qytet të zhvilluar, urbanizimi dhe industrializimi kishin ndodhur me hapa të shpejtë. Asokohe, ndotja e ajrit në qytete prej djegies së qymyrit ishte kthyer në një shqetësim dhe shtypi anglez si edhe shkrimtarët dhe piktorët, e përshkruanin ajrin e ndotur që mbulonte Londrën viktoriane duke përdorur fjalë dhe imazhe me ngarkesë poetike dhe enigmatike.

Këto përshkrime dhe imazhe u ngulitën fort në mendjen e publikut por Smogu i Madh nuk u ndal dhe arriti të kaplojë Londrën. Kjo bëri që në vitin 1856, të merren masat e para ligjore për reduktimin e ndotjes së ajrit. Ky moment konsiderohet i rëndësishëm për lëvizjen mjedisore kudo në Botë. Dhe një rol kanë këtu edhe gazetatat e kohës.

Pas Luftës së Dytë Botërore në Europë dhe SHBA, rreth viteve 1950, nisën protestat dhe u shfaqën lëvizjet mjedisore që synonin ndryshime rrënjësore në dobi të shëndetit të publikut dhe mjedisit. Ka mendime se një nga shtysat për rritjen e ndërgjegjësimit tek publiku ishte vepra e biologes dhe gazetares amerikane Rejçell Karson me titull “Pranvera e heshtur” botuar për herë të parë në vitin 1962.

Në të njëjtën periudhë, shqetësimet kryesore që gjenin pasqyrim të madh në media kishin të bënin me ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës, me biodiversitetin në veçanti. Në ditët e sotme, koncepti biodiversitet, ka nuanca të ndryshme. Këto nuanca ose ky ambiguitet, ndikon edhe në perceptimin e publikut.

Së fundmi, biodiversiteti kuptohet si i lidhur ngushtë me funksionet dhe shërbimet e ekosistemeve. Megjithëse frika për humbjen e biodiversitetit ka qenë e pranishme tek publiku që prej fillimshekullit të XX, mesazhi publik për rreziqet e tij, për shkak të ambiguitetit të konceptit dhe përdorimit të tij në mënyra të ndryshme, ngjan si rebus dhe nuk ka ndonjë ndikim në perceptimin e publikut.

Në periudhën 1969- 1974 presidenti amerikan R. Nikson, që e konsideronte veten pasues të zellit mjedisor të shfaqur më herët prej presidentit T. Ruzvelt, i dha prioritet në agjendën e tij problemeve që lidheshin me mjedisin: themeloi Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit dhe nënshkroi një sërë ligjesh, që kishin si qëllim mbrojtjen e llojeve dhe ruajtjen e llojeve që rrezikonin zhdukjen si dhe kufizimin e ndotjes së ajrit dhe të ujit. Nikson la pas një trashëgimi të vyer në dobi të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të popullatës.

Por kriza klimatike ende nuk po gjente vendin e merituar në media. Kjo situatë vazhdoi dhe përgjatë viteve 1970-1980, kur korporatat e nxjerrjes dhe përpunimit të karburanteve fosile, nisën përhapjen e informacioneve të pavërteta në media, duke krijuar dyshime deri në mosbesim tek publiku mbi shtimin e CO2 në atmosferë prej djegies së karburanteve.

Në fund të viteve 1980, në SHBA ndodhën zjarre dhe thatësira të mëdha. Shkencëtari amerikan J. Handen dëshmoi para Kongresit mbi faktin se ngrohja e temperaturave i detyrohej djegies së karburanteve fosile. Së bashku me zjarret e thatësitat, ky pohim e tronditi publikun amerikan dhe kjo u pasqyrua gjerësisht në media. Deklarata të ngjashme, nisën të merreshin seriozisht prej gazetarëve. Kështu, nisi periudha e raportimit më të shpeshtë të ndryshimeve klimatike në media. Në vitin 1989, u themelua Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike.



Photo: Edward Byrtynsky

Në këto 50 vitet e fundit, tek publiku vërehet një përfshirje dhe rritje e shqetësimit për pasojat e krizës klimatike. Bazuar në një studim të realizuar në vendet e Bashkimit Europian dhe Britaninë e Madhe, frika prej pandemisë COVID-19 rriti edhe shkallën e shqetësimit për krizën klimatike dhe nivelin e ndërgjegjësimit, një fakt i pavërejtur pas krizës financiare të vitit 2008.

Pas viteve 2000 bindjet dhe qëndrimet për ndryshimet klimatike në SHBA janë politizuar së tepermi, duke sjellë një ndarje mes Demokratëve dhe Republikanëve. Ky dallim, vërehet dhe në Europë, mes të majtëve dhe të djathtëve, sidomos në Europën Perëndimore, dhe më pak në atë Qendore dhe Lindore. Ata që nuk votojnë janë më pak të shqetësuar për krizën klimatike, ndërsa siç mund të merret me mend, votuesit e partive të gjelbra janë më të ndërgjegjësuar krahasuar edhe me votuesit që vetë-identifikohen si të majtë.

Në Europë, ndryshimet klimatike aktualisht perceptohen si një realitet shqetësues. Natyrisht ekzistojnë disa ndryshime të vogla në nivelin e ndërgjegjësimit dhe perceptimit të riskut mes vendeve europiane. Konkretisht, vendet e Europës Lindore, shfaqin një nivel më të ulët ndërgjegjësimi.

Perceptimet mbi ndryshimet klimatike bashkëveprojnë me mënyrën se si ndryshimet klimatike portretizohen në lajme, që tani aksesohen më shpejt dhe më me lehtësi në rrjetet sociale. Në këtë ekosistem të ri, përdoruesit përfshihen në diskutime me tematikë klimatike dhe bashkëveprojnë përmes mjeteve (celularëve, laptopëve, etj) dhe formave të ndryshme (publikimeve, shpërndarjeve etj). Gjithashtu, në mediat sociale, nuk ekziston një hierarki e informacionit klimatik, nuk është e qartë se kush i krijon

lajmet dhe kush i merr ato si dhe mungojnë filtrat profesionalë, siç ishim mësuar më parë.

Gjithsesi ende nuk njihet plotësisht shkalla e ndikimit në sjellje në dobi të përmirësimit të krizës klimatike, prej konsumimit të lajmeve përmes mediave sociale. Deri më tani, vërehen dy fakte shqetësuese. Fakti i parë është se angazhimi i madh në rrjetet sociale si Facebook-u, pra koha e lartë e shpenzuar në platformë, ul nivelin e pjesëmarrjes qytetare për përmirësimin e krizës klimatike. Fakti i dytë është se informimi prej Facebook-ut, ul shkallën e reagimit të qytetarëve.

Nga pikëpamja sasiore, të dhënat tregojnë se numri i artikujve që lidhen me klimën ka njohur rritje të konsiderueshme gjatë dekadës së fundit. Një studim i raportimit të ndryshimeve klimatike në media në 59 vende, zbulon se gjatë dyvjeçarit 2016-2017 në media ishin botuar 47.000 artikuj për klimën kurse në dyvjeçarit 2020-2021, ishin botuar rreth 87.000 artikuj, pra rreth dyfish më shumë. Kjo tregon se raportimi i ndryshimeve klimatike në media ka pësuar rritje, duke sjellë edhe rritjen e rolit të mediave në informimin dhe ndërëgjegjësimin e publikut për këto zhvillime.

7

PRINCIPET QË DUHET TË UDHËHEQIN MEDIAT NË QASJEN E TYRE NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Në politikat e tyre editoriale, mediat drejtohen ose duhet të drejtohen gjithmonë nga principet e interesit publik. Ndryshimet klimatike prekin në një spektër të gjerë jetesën, veprimtarinë dhe interesat e publikut të gjerë, për këtë arsye raportimi për to duhet të udhëhiqet nga ato principe që janë në një linjë me këto interesa të përgjithshme. Duke patur parasysh kontekstin shqiptar, më poshtë po shtjellojmë principet më të rëndësishme dhe më relevante për këtë kontekst ku duhet të bazohet edhe politika editoriale e mediave:

Nuk është problem vetëm i vendeve të mëdha. Dhe as vetëm i mediave të mëdha


Në përgjithësi, elita e shoqërisë shqiptare – kemi parasysh këtu klasën politike, por edhe elitat ekonomike, sociale si dhe elitat e medias – e shohin problemin e klimës si një problem të vendeve të mëdha. Mirëpo problemet e klimës nuk mund të trajtohen si problem i G8, G20 ose si problem i organizatave të ndryshme ndërkombëtare apo i superfuqive të mëdha. Këto janë probleme për çdo vend, pavarësisht nga përmasat. Janë probleme edhe për qytetet e mëdha, por edhe për një fshat ku banojnë shumë pak bujq apo blegtorë, pasi pasojat e problemeve të klimës janë të atilla që afektojnë çdo individ dhe çdo zonë të rruzullit tokësor.

Përveç kësaj, shpeshherë nga ana e mediave tona, problemet e klimës trajtohen si çështje të mediave globale. Natyrisht, ndryshimet klimatike janë një problem që duhet raportuar nga New York Times apo nga media të tjera të mëdha ndërkombëtare. Por kjo nuk do të thotë se ky raportim nuk është çështje e mediave tona. Vërtet zhvillimet e klimës kanë natyrë globale, por pasojat e tyre janë sa globale aq edhe lokale. Nga ana tjetër, raportohet për samite të rëndësishme ndërkombëtare, dhe nuk raportohet për evente dhe takime që bëhen në Shqipëri, lidhur me klimën. Kjo ka bërë që të kemi një lloj paragjykimi ndaj problemeve të klimës dhe ka sjellë situatën ku problemet e klimës janë shtyrë në periferi, edhe pse, në qoftë se do t'i referohemi interesit publik, këto janë një lloj të rëndësishme, në mos edhe më të rëndësishme se disa tema në të cilat është përqendruar sot media.

Nuk sjell klikime, por sjell humbje jetësh njerëzore

Jo vetëm kriza klimatike, por edhe çështjet e klimës në përgjithësi nuk kanë gjetur vendin e duhur në mediat shqiptare. Në qoftë se do t'i referohemi axhendës së tyre, çështjet e klimës në këtë axhendë janë shumë pak të pranishme. Kjo vjen për arsye se mediat shqiptare kanë një axhendë të super-politizuar dhe të tabloidizuar, që do të thotë se janë orientuar nga ato lloj artikujsh apo nga ai lloj informacioni që supozohet sipas tyre të tërheqë më shumë klikime apo shikime. Ndërkohë klimën e neglizhojnë, e lënë si një tematikë periferike edhe pse nga pikëpamja e dëmit, klima dhe çrregullimet e saj, siç është përshebull ngrohja globale, janë me pasoja shumë herë më të mëdha se sa fatkeqësitë e vogla lokale për të cilat mediat raportojnë. Kështu që është urgjente dhe e domosdoshme, ndoshta edhe me insistimin e vetë trupës së gazetarëve, por edhe të organizatave të

shoqërisë civile - siç është përshembull Instituti Shqiptar i Medias- që në axhendën e mediave, klima dhe çështjet e saj të jenë gjithnjë e më shumë të përfshira.



Burimi: <https://www.climatecentral.org/climate-matters/seniors-at-risk-heat-and-climate-change>

Njohja shkencore bën diferencën në raportim, por...

Njohja dhe raportimi i problemeve të krizës klimatike prej mediave, rrit në mënyrë të pashmangshme edhe njohjen dhe ndërgjegjësimin e publikut për realitetin klimatik. Por që të mundësohet përmbushja e rolit të mediave nevojitet që vetë gazetarët e angazhuar në këtë fushë të kenë njohuritë e duhura dhe të jenë të mirë-informuar për atë që ndodh. Nuk mund të kemi qytetarë të mirë-informuar pa gazetarë të mirë-informuar.

Gazetaria klimatike, duke qenë në një mënyrë edhe një lloj gazetarie shkencore e ka të domosdoshme njohjen e thellë të termave,

koncepteve, të dhënave dhe zhvillimeve në këtë fushë. Për këtë arsye nga gazetarët e angazhuar në çështjet e klimës kërkohet:

- ⊙ *Njohja e bazave të shkencës së klimës.* Me këtë nuk kemi parasysh një diplomim të plotë, edhe pse do të ishte ideale që një gazetar i klimës të mund të mbaronte, përshembull, një master profesional në këtë fushë në një nga vendet që e ofrojnë atë. Bazat e shkencës klimatike mund të merren edhe përmes leximit dhe studimit individual, por edhe në kurse të ndryshme trajnimi.
- ⊙ *Një bashkëveprim më i ngushtë me shkencëtarët dhe specialistët e fushës.* Kjo kërkon që të dhënat, faktet dhe informacioni i mbledhur të konsultohet edhe me njerëzit kompetentë përpara se shkrimet apo materialet të botohen.
- ⊙ *Krijimi i hapësirave në media për shkencëtarët apo specialistët.* Bashkëpunimi me shkencëtarët apo specialistët duhet të jetë i ndërsjelltë. Nga njera anë mediat dhe gazetarët përdorin ekspertizën e tyre (natyrisht duke i cituar) për të verifikuar apo saktësuar burimet apo informacionet e mbledhura, por nga ana tjetër nevojitet që për ta të krijohen edhe hapësira në media për botimin e materialeve apo kontributeve të tyre të përshtatura në stilin e mediave.
- ⊙ *Referimi i studimeve shkencore mbi krizën klimatike.* Konsultimi dhe referimi i studimeve apo botimeve shkencore është një mënyrë e mirë për të provuar të vërtetën që ju synoni të përcillni në përmbajtjen tuaj mediatike. Citimi i një artikulli shkencor apo i një reviste prestigjioze shkencore vlen shumë më shumë se sa opinionet subjektive të individëve të intervistuar në një VoxPop.
- ⊙ *Pjesëmarrja në veprimtaritë shkencore, si konferenca, seminare, etj.* Këtu kemi të bëjmë me një praktikë të dyfishtë

përfitimi: Së pari, konferenca dhe gjetjet kryesore të saj mund të shërbejnë si subjekt për të cilin do të flitet në lajmin tuaj të radhës. Së dyti, veprimtari të tilla ju mbajnë të përditësuar me zhvillimet e fushës dhe ndihmojnë për të kuptuar prirjet dhe pritshmëritë.

Gjithsesi, në këtë bashkëpunim të domosdoshëm me shkencëtarët dhe specialistët, nuk duhet të harrojmë tek e fundit që gazetarët janë aty për të bërë gazetari dhe jo shkencë. Respektimi i standarteve bazë të të shkruarit për mediat, siç janë thjeshtësia dhe qartësia janë të detyrueshme edhe për gazetarinë klimatike. Mbingarkimi me terma shkencorë të pakuptueshëm për shumicën e publikut, mos-shpjegimi i tyre, përdorimi i zhargonit, etj., duhet të evitohen. Është e vërtetë që njohja shkencore e një çështjeje që lidhet me klimën bën diferencën në një raportim mediatik për këtë çështje, por kjo njohje duhet të shprehet në një mënyrë të tillë që ta bëjë më të lehtë kuptimin e problemit nga ana e audiencës dhe jo e kundërta.

“Respektimi i standarteve bazë të të shkruarit për mediat, siç janë thjeshtësia dhe qartësia janë të detyrueshme edhe për gazetarinë klimatike”

Nuk është fanta-shkencë dhe as problem i dorës së dytë

Skeptikët ndaj ekzistencës së ndryshimeve klimatike shpesh i paraqesin këto ndryshime si inekzistente apo si fanta-shkencë. Siç e kemi përmendur edhe më lart, kanë qenë pikërisht shkaktarët e ndryshimeve klimatike – industritë e mëdha që kanë si burim

energjie djegien e karburanteve fosile – të cilët kanë financuar studime pseudo-shkencore për të “provuar” se rritja e nivelit të dioksidit të karbonit në ajrin e Tokës nuk ndikon tek ngrohja globale. Madje ka patur edhe zëra të tillë që e kanë mohuar dukurinë e ngrohjes globale.

Përkundër këtyre zërave, media duhet të pozicionohet fort në anën e së vërtetës dhe të bëhet faktor i fuqishëm i evidentimit të pasojave konkrete të ndryshimeve të klimës dhe i denoncimit të atyre lloj bizneseve apo veprimtarive njerëzore që bëhen shkak i këtyre ndryshimeve. Njëherësh, mediat dhe gazetarët duhet të jenë edhe kundër zërave që e konsiderojnë krizën klimatike si një problem të dorës së dytë apo si diçka e vogël e parëndësishme që zhvillohet larg jetës normale të njerëzve. Faktet shkencore dhe empirike flasin që dëmet janë aty, gjithnjë e më të shtuara dhe më me pasoja në jetën, ekonominë dhe mirëqënien e shoqërisë.

Nuk është investim i humbur

Duke iu referuar situatës së mediave shqiptare në raport me çështjet e klimës, mund të themi se një problem i madh këtu mbetet mungesa e investimeve për profilizimin e gazetarëve. Madje nuk bëhet fjalë vetëm për klimën, por edhe për mjedisin në përgjithësi, për shkencën, për menaxhimin e territorit, etj.

Është e kuptueshme që një vend pune për një gazetar i cili do të merret vetëm me problemet e klimës, nuk do të ishte një gjë efektive për median, sepse nuk ka qasur shumë informacion dhe kaq shumë raportim dhe mbulim sa të justifikohet pagesa e tij. Por, ndërkohë, nëse dikush – një nga gazetarët e redaksisë – profilizohet krahas –

le të themi – problemeve sociale, edhe për problemet e klimës dhe të mjedisit në përgjithësi, atëhere ky investim do të ishte shumë i justifikuar edhe për vetë mediat nga pamja ekonomike por edhe shoqërisht i justifikuar pasi media në këtë rast do të shlyente një detyrim të rëndësishëm me interes të lartë publik, siç është detyrimi ndaj kauzës së ndryshimeve klimatike.

Çdo lloj investimi nga ana e mediave për një mbulim më të gjerë, më efektiv dhe më gjithëpërfshirës të problemeve të krizës klimatike, jo vetëm që nuk është i humbur, por ai kthehet disafish në termat e jetëve të shpëtuara si dhe të krijimit të një të ardhmeje më të sigurtë për shoqërinë njerëzore.

Është diçka që nuk pret për nesër

Mënyra kryesore e derisotme e sjelljes së shumicës së njerëzve me pushtet ka qenë ajo që i ka konsideruar ndryshimet klimatike si diçka që pret, si një çështje që i takon të ardhmes. Kështu në Shqipëri, pavarësisht nga insistimi i hershëm i faktorëve ndërkombëtarë, reagimi më i madh i ndërmarrë ndonjëherë nga qeveria për minimizimin/zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike (edhe ky në sajë të presionit për plotësimin e kushteve për anëtarësimin në BE) është thjesht hartimi i Strategjisë ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri 2020-2030. Madje, siç rezulton nga monitorimi i planit të veprimit për vitet 2020-2021, edhe kjo strategji është përqendruar vetëm në planin e përshtatjes me ndryshimet klimatike, duke injoruar aspektin kryesor dhe më të rëndësishëm: atë të zbutjes apo minimizimit të pasojave të këtyre ndryshimeve.

Kjo sjellje që e zvarrit marrjen e masave duke e shtyrë për në kalendat greke duhet denoncuar nga ana e mediave. Edhe këto të fundit nuk duhet të bien në kurthin e idesë se kjo është diçka që pret, përkundrazi të veprojnë sot, pasi nesër do të jetë shumë vonë.

8

DHJETË REKOMANDIME PËR NJË GAZETARI KLIMATIKE MË TË MIRË

Ndryshimet klimatike përbëjnë kontekstin e gjerë të raportimit për gazetarinë klimatike. Ato janë të mpleksura me një numër të madh faktorësh natyrorë, shoqërorë, kulturorë, ekonomikë, politikë, etj. Në këtë këndvështrim, të shkruash për ndryshimet klimatike kërkon njohuri të thella të fushës dhe aftësi profesionale. Në një manual për gazetarinë klimatike, specialistët e angazhuar nga UNESCO paraqesin 10 rekomandime të dobishme për gazetarët, për të bërë një gazetari të mirë në këtë fushë.¹ Po i paraqesim më poshtë këto rekomandime të përshtatura në gjuhën shqipe:

- 1) ***Njihni audiencën tuaj.*** Kur uleni për të shkruar, përballë jush duhet të keni vetëm një subjekt që ka rëndësi: nuk jeni ju, nuk është redaktori juaj dhe jo personi që sapo intervistuat. Është lexuesi, dëgjuesi dhe shikuesi – dikush që ju mund të mos keni gjasa ta takoni ndonjëherë. Bëhuni familjarë me nivelin e njohjes së audiencës suaj rreth ndryshimeve klimatike, dhe rreth gjërave më të rëndësishme për ta. Nëse jeni të pasigurt, mendoni sikur audienca nuk ka njohuri, por kurrë mos bëni gabimin që të supozoni se pjesëtarët e audiencës janë “idiotë”. Gabimi klasik në gazetari është mbivlerësimi i njohjes së audiencës dhe

¹ *Getting the Message Across - Reporting on Climate Change and Sustainable Development in Asia and the Pacific: A Handbook for Journalists*; Link: https://en.unesco.org/sites/default/files/getting_the_message_across_climate_change_asia_pacific_web_2018.pdf

nënvlerësimi i inteligjencës së tyre. Përpara se të përfundoni një shkrim, mbani parasysh audiencën. Lexojeni të gjithë shkrimin. Vendoseni veten në vendin e një pjesëtari tipik të audiencës suaj, dhe imagjinoni pyetjet që ata mund të bëjnë për artikullin tuaj. Pas kësaj, përgjigjuni këtyre pyetjeve në shkrimin tuaj përpara se ta dorëzoni atë për botim.

- 2) **Punoni në grup.** Për të raportuar rreth një ngjarjeje që lidhet me ndryshimet klimatike, duhet të kuptoni dhe të prezantoni saktësisht aspektin shkencor, politik, ekonomik, etj., të saj. Por askush nuk mund të shkëlqejë në të gjitha këto aspekte. Edhe superheronjtë arrijnë më shumë kur janë pjesë e një grupi. Kështu që bëhuni grup me gazetarë të tjerë. Gazetari Eric Pooley kërkon nga mediat që të krijojnë ekipe të politikës klimatike që të përfshijnë reporterë të shkencës dhe mjedisit, reporterë të politikës dhe biznesit, si dhe reporterë të energjisë. Duke punuar së bashku, ky grup miks do të jetë në gjendje që të kombinojë forcat e veta për të raportuar më efektivisht në të treja këto kënde, të cilat janë thellësisht të lidhura, por zakonisht, të raportuara veçmas nga njëra-tjetra.
- 3) **Lokalizoni termat apo zhargonin.** Ju mund ta dini se ç'është CDM, REDD+ apo UNFCCC, por lexuesi, ose dëgjuesi, ose shikuesi juaj mund të mos ia ketë idenë. Nëse i intervistuari juaj përdor zhargon, kërkonte prej tij që ta thjeshtëzojë gjuhën. Nëse ai flet me terma të komplikuar, kujtojeni që edhe pse ai mund të ketë punuar për vite të tëra në fushën e ndryshimeve klimatike, ju si gazetar e keni filluar kërkimin për subjektin specifik vetëm disa ditë, apo disa orë më parë. Kujtojeni atij që është pjesë e punës suaj që audienca të kuptojë çdo fjalë dhe

term. Shumica e ekspertëve do të preferonin t’ju jepnin një mesazh më të thjeshtë në gjuhën e tyre se sa t’i thjeshtonin gjërat për ju. Mos kini siklet t’i drejtoheni: “Nuk ju kuptoj. A mund të ma shpjegoni përsëri?”.

- 4) ***Jini vizual.*** Shumë prej historive të klimës apo mjedisit janë komplekse, por ato shpesh mund të ilustrohen me pamjet e duhura që prezantojnë çështjen dhe e bëjnë atë një histori njerëzore më tërheqëse. Gazetarët duhet gjithmonë t’i bëjnë vetes pyetjen: “Si mund ta vizualizoj këtë histori?”. Kjo ndoshta mund të bëhet përmes një foto-eseje, përmes një serie portretesh, një videoje të shkurtër shpjeguese online, një dokumentari të thelluar, apo përmes një infografike të qartë dhe të lehtë për t’u kuptuar. Një seri fotosh apo videosh të bukura mund ta shpjegojnë më konkretisht një çështje tek lexuesit. Projektet multimediale janë gjithashtu shumë efektive për mjedisin online sepse ato e paraqesin një ngjarje duke kombinuar një numër elementësh vizualë, si fotot, videot dhe infografikat. Përdorini të gjitha burimet që keni për ta sjellë historinë të gjallë – titujt, fotografitë, grafikët, hartat, etj.
- 5) ***Merrni një opinion të dytë*** – dhe pse jo edhe të tretë. Të intervistuarit tuaj mund ta kenë gabim. Ata mund të jenë të njëanshëm. Ata mund të kenë interesat e tyre vetjake në mes. Pyesni veten se pse ata e thonë një gjë në mënyrën që ata e thonë, dhe mundohuni të kuptoni nëse ata synojnë që të përfitojnë nga raportimi juaj përmes fjalëve të tyre. Kërkoni opinionin e ekspertëve të tjerë nga institucione të tjera.
- 6) ***Citoni zëra të ndryshëm.*** Ndryshimet klimatike afektojnë gjithkënd, dhe gjithsecili mund të reagojë ndaj tyre në mënyra

të ndryshme. Mendoni njëkohësisht si për gjininë, edhe për generatën. Ndryshimet klimatike ndikojnë në mënyra të ndryshme tek burrat dhe gratë. Të rinjtë dhe më të moshuarit janë më të prekshëm se sa njerëzit e shëndetshëm të moshës së mesme. Ata gjithashtu kanë këndvështrime të ndryshme. Më të moshuarit kanë kujtime afatgjata dhe mund të përshkruajnë ndryshimin e ndodhur për disa dekada. Të rinjtë do t'i trashëgojnë problemet e ndryshimeve klimatike, dhe për këtë arsye mund të kenë perspektiva të fuqishme. Duke iu drejtuar kategorive kaq të ndryshme të njerëzve rreth ndryshimeve klimatike, ju do të përftoni një kuptim më të pasur, ide shkrimesh më të shumta dhe kënde të reja të të treguarit të ngjarjes.

“Duke iu drejtuar kategorive të ndryshme të njerëzve rreth ndryshimeve klimatike, ju do të përftoni një kuptim më të pasur, ide shkrimesh më të shumta dhe kënde të reja të të treguarit të ngjarjes”

- 7) ***Mblidhni reagimet.*** Është e rëndësishme për gazetarët që të intervistojnë qytetarët e thjeshtë dhe të krijojnë një platformë për zërin e atyre që preken më shumë nga ndryshimet e klimës. Komunitetet më të varfra janë shpesh më të riskuara që këndvështrimi i tyre të mbetet në përgjithësi i pa-raportuar. Të citoni anëtarët e komuniteteve të rrezikuara është një mënyrë e mirë për t'i dhënë karakter njerëzor tematikave shkencore komplekse. Por kini parasysh se është e rëndësishme që të verifikoni faktet e tyre duke i ballafaquar me raportet kërkimore dhe me të dhënat rreth kësaj tematike.

- 8) **Humanizoni, humanizoni, humanizoni.** Mbi gjithçka tjetër, njerëzit tregojnë interes për shëndetin e tyre, për pasurinë dhe për të ardhmen e fëmijëve. Ndryshimet klimatike lidhen ngushtë me të treja këto aspekte. Kështu që përpiquni që t'i keni parasysh kur përgatiteni për të treguar një ngjarje tek redaktori apo tek audienca juaj. Shndërrojini gjërat abstrakte në reale.
- 9) **Përdorini drejt deklaratat e shtypit.** Shumë shpesh, gazetarët bëjnë “copy-paste” deklaratat e shtypit dhe thjesht vendosin emrin e vet poshtë tyre. Në këtë mënyrë, ata bëjnë një keqshërbim ndaj lexuesve. Një deklaratë shtypi nuk është një shkrim, por një informacion që mund të përmbajë embrionet e një shkrimi të cilin gazetari duhet ta zhvillojë më tej. Ndërkohë që deklaratat ndërkombëtare të shtypit mund të jenë relevante, ato asnjëherë nuk mund të jenë shkruar duke patur në mendje audiencat e secilit vend apo gazetar. Lokalizojini ato, jepuni perspektivë të re dhe bëjini me kuptim për audiencën tuaj.
- 10) **Tregoni histori suksesi.** Ndryshimet klimatike kanë nxitur shpesh imagjinatën dhe gjenialitetin njerëzor. Anëmbanë botës, individët po provojnë se përmes inovacionit, bashkëpunimit dhe mobilizimit, zgjidhjet për ndryshimet klimatike jo vetëm që ekzistojnë, por ato gjithashtu ofrojnë mënyra të reja të të siguruarit të jetesës. Vlera e vënies në dukje të këtyre rasteve nuk qëndron vetëm në krijimin e një buzëqeshjeje tek lexuesit, por edhe tek demonstrimi i asaj që është e mundshme.

9

MËNYRA EFEKTIVE TË TË BËRIT GAZETARI KLIMATIKE

Zhvillimet dhe ngjarjet që lidhen me ndryshimet klimatike janë të pazakonta, emergjente dhe me pasoja të mëdha. Ato nuk mund të përcillen nga mediat si diçka rutinore, pa nerv reagues dhe pa emocion. Raportimi për krizën klimatike kërkon përdorimin e zhanreve apo formateve efektive të cilat garantojnë tërheqjen e vëmendjes së publikut, përfshirjen emocionale dhe angazhimin civil të tij.

Duke qenë të ekspozuara në natyrë dhe në hapësira urbane apo rurale, pasojat e ndryshimeve klimatike, siç e kemi përmendur edhe më sipër, mund të vijnë më mirë në media përmes formave vizuale të raportimit, të cilat sidomos në kohën e sotme të zhvillimeve të reja në teknologjinë e informacionit po njohin një përparësi të dukshme. Fotografitë, videot, infografikat, hartat, vizualizimet e të dhënave, galeritë, etj., mbartin në vetvete pushtetin dhe supremacinë e imazhit në raport me format e tjera të informimit.

Nga ana tjetër, kombinimi i medimeve të ndryshme për të raportuar për një ngjarje apo zhvillim ose e thënë ndryshe përdorimi i “*multimedia storytelling*” (raportimi multimedial) për të informuar publikun lidhur me ndryshimet klimatike do të ishte një vlerë e shtuar për gazetarinë e klimës. Por natyrisht kjo nuk do të thotë se duhet injoruar edhe përdorimi i kapaciteteve të tekstit dhe të audios,

të cilat në situata apo rrethana specifike mund të jenë zgjedhja më efektive për raportim.

Duke u bazuar edhe në përvojën më të mirë botërore, po paraqesim më poshtë zhanret apo mënyrat më efektive të raportimit të problemeve të klimës, me përparësitë apo specifikat e secilës prej tyre:

Dokumentarët e thelluar: Gjithsecilit prej nesh i ka rënë rasti të shohë dokumentarët e mrekullueshëm që transmetohen në Discovery Channel apo National Geographic Channel. Mes të tjerash ato evidentojnë kapacitetet që ka ky zhanër për të mbajtur gjithë kohës të gjallë vëmendjen dhe interesin e shikuesit. Në rastin e ndryshimeve klimatike, dokumentarët e thelluar japin mundësinë e paraqitjes reale dhe shumëplanëshe të gjendjes, duke e vendosur atë në një kontekst të gjerë. Ato sjellin në ekran zërat e njerëzve nga terreni, përvojën dhe perceptimin e atyre që i vuajnë drejtpërdrejt pasojat dhe që përballen çdo ditë me to si dhe ballafaqojnë qëndrimet zyrtare me realitetin konkret.

Videot e shkurtra: Popullariteti që kanë fituar në dekadën e fundit *reels* të Facebook dhe Instagram apo e videot e shkurtra të TikTok flet për suksesin e këtij formati videoje si dhe për prirjen që ka audienca për të konsumuar informacion në një kohë sa më të shkurtër të mundshme dhe përmes planeve vizuale më pikante dhe më domethënëse. Në rastin e ndryshimeve klimatike ky format mund të përdoret me sukses për të denoncuar përmes pamjeve në video pasojat katastrofike të krizës klimatike. Një praktikë dhe raportim i tillë ka përparësinë e ekonomizimit të vëmendjes së përdoruesve online dhe të sensibilizimit të menjëhershëm të tyre. Njëherësh videot e shkurtra janë shumë efektive për të përfshirë në kauzën e ndryshimeve klimatike grup-moshat e reja.

Raportimet multimediale: Një raportim multimedial i Washington Post për pasojat e tornados në Puerto Rico, u shpall më i miri i vitit 2017 në llojin e vet. Nëse do ta shikoni (gjendet në linkun <https://www.washingtonpost.com/graphics/2017/national/puerto-rico-life-without-power/>) do të konstatooni fuqinë shprehëse dhe kapacitetet e mëdha përfshirëse që ka ky lloj raportimi në raste të tilla siç janë fatkeqësitë e mëdha klimatike.




Burimi: <https://www.washingtonpost.com/graphics/2017/national/puerto-rico-life-without-power/>

Raportimi multimedial mbledh në një paketë edhe gazetarinë, edhe emocionet, edhe përfshirjen civile. Ai bën të mundur prezantimin në web të një ngjarjeje apo problematike përmes përdorimit të kombinuar të disa medimeve, si fotografia, video, audio, teksti, animacionet, grafikët informative, etj., në një format jo-linear në të cilin çdo medium është plotësues, jo shterues, duke realizuar paraqitjen e ngjarjes jo në një strukturë të vetme narrative, por përmes alternativave të shumta në dispozicion të zgjedhjes së publikut.

Podcasting: Si formati më i suksesshëm i gazetarisë së audios në internet, *podcasting* ofron mundësi specifike për të ndikuar përmes fjalës së folur. Dëshmitë apo komentet zanore, të shoqëruara edhe me një sfond muzikor dramatik apo emocionues, mund të jenë shumë të efektshme gjatë raportimit për ngjarjet apo zhvillimet prekëse që lidhen me çështjen e ndryshimeve klimatike.

Fotografitë apo slajdet fotografike: Fotografia nuk ka vetëm kapacitetet që të flasë sa njëmijë fjalë, por gjithashtu ajo e përcjell mesazhin në mënyrë të koncentruar dhe shumë më shpejt se sa teksti. Ekspertët e mediave sot vlerësojnë edhe fuqinë e imazhit për të qenë më i kapshëm nga syri dhe për të mundësuar një reagim të shpejtë. Pamjet nga fatkeqësitë apo pasojat e ndryshimeve klimatike të sjella përmes foto-lajmeve, foto-slajdeve apo përmes galerive fotografike mund të shërbejnë si një mënyrë shumë e mirë për të sjellë në sytë e publikut të gjerë atë që ndodh shpesh larg syve të tyre.

Vizualizimi i të dhënave: Në një kohë kur informimi i publikut kërcënohet nga lajmet e rreme apo nga opinionet personale, gazetaria e të dhënave vjen si një alternativë që provon se kur flet përmes shifrave, je gjithnjë e më i besueshëm. Nga ana tjetër, kur këto shifra paraqiten vizualisht përmes infografikave, piktogramave, apo hartave të nuancuara, sukcesi në arritjen e audiencës është i shumëfishtë. Përdorimi i këtyre vizualizimeve në raportimin për klimën ju bën më afërt dhe më të preferuar nga lexuesit. Sot në web ka mjaft platforma që ndihmojnë dhe lehtësojnë shumë vizualizimin, siç janë: Many Eyes, Carto, Data Wrapper, Tableau Public, Google Fusion Tables, Piktochart, etj. Ndërkohë Climatedata paraqet hartat globale interaktive të të dhënave për klimën që nga viti 1961 deri në 2016.



Burimi: ClimateMaps, <https://www.ecoclimax.com/2016/08/climate-maps.html>

Dokumentarët apo artikujt investigative: Ndryshimet klimatike kanë edhe një anë të errët që lidhet me ato lloj aktiviteteve njerëzore që në emër të fitimit kontribuojnë në shtimin e pasojave dhe të fatkeqësive. Ky aspekt mund të raportohet me efektivitetin përmes dokumentarëve apo artikujve investigativë. Në Shqipëri, edhe pse janë sporadike, investigimet e kësaj fushe nuk mungojnë. Një pikë referimi shumë e mirë për të mësuar dhe për të përfitur në këtë drejtim mund të jetë puna e gazetarëve të platformës investigative BIRN Albania. Në linkun <https://www.reporter.al/2022/10/11/krim-mjedisor-autoritetet-bene-nje-sy-qorr-ndaj-demtimit-te-lagunes-se-kune-vainit/> do të gjeni një rast të mirë raportimi përmes kapaciteteve të gazetarisë investigative.

“Breaking news”: Lajmet nga ngjarjet dhe zhvillimet klimatike, sidomos kur ato përcillen prej edicioneve kryesore apo kur botohen në faqet e para të portaleve apo gazetave, kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme që çështjet e klimës të vendosen në krye të axhendës së

mediave dhe të debatit public si dhe të arrijnë një audiencë shumë të gjerë. “Breaking news” nga kriza klimatike duhet të jenë gjithnjë e më të pranishme në media pasi ato transmetojë me shumë efektivitet sensin e urgjencës, të alarmit dhe të përgjegjësisë me të cilat duhet të trajtohen problemet e kësaj krize.

Blogjet: Sjellja e eksperiencave apo qëndrimeve personale në raport me ndryshimet klimatike mund të realizohet shumë mirë përmes një blogu. Për fat të mirë, platforma të tilla si Wordpress e kanë lehtësuar procesin duke e bërë krijimin dhe mbajtjen e një blogu të mundshëm për këdo. Rasti i blogut Klima Sot (<https://klima.al/>) tregon se përdorimi i blogut si një medium informimi për ndryshimet klimatike është një zgjedhje efektive edhe në Shqipëri.



Burimi: Klima Sot (<https://klima.al/>)

Editorialet dhe komentet: Në trupën e gazetarëve, ekspertëve, specialistëve apo të shoqërisë civile ka shumë individë të cilët jo vetëm janë të ndjeshëm dhe të përfshirë në kauzën e ndryshimeve klimatike, por edhe dallohen për forcën e argumentit dhe për aftësi bindëse. Këta individë mund të përfshihen në media përmes analizave apo komenteve, përmes “talk show”, përmes intervistave, dhe pse jo edhe përmes editorialeve. Fusha e analizës dhe e raportimit të krizës klimatike, duke qenë e shumë-debatuar, ka nevojë për argumente të thella dhe të qëndrueshme në mënyrë që të sigurojë përkrahjen e një numri gjithnjë e më të gjerë njerëzish.

“Fusha e analizës dhe e raportimit të krizës klimatike, duke qenë e shumë-debatuar, ka nevojë për argumente të thella dhe të qëndrueshme në mënyrë që të sigurojë përkrahjen e një numri gjithnjë e më të gjerë njerëzish”

Fusha e analizës dhe e raportimit të krizës klimatike, duke qenë e shumë-debatuar, ka nevojë për argumente të thella dhe të qëndrueshme në mënyrë që të sigurojë përkrahjen e një numri gjithnjë e më të gjerë njerëzish

Një punë e dobishme në këtë aspekt mund të realizohet edhe përmes influencuesve (anglisht: influencers) të webit, të cilët kanë ndjekës të shumtë apo kredibilitet të lartë në mesin e lexuesve dhe të përdoruesve të internetit.

10

SFIDAT E GAZETARISË KLIMATIKE SHQIPTARE

Gazetaria klimatike në kohën e sotme po përballet me një numër sfidash të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në suksesin dhe realizimin e misionit të saj. Ja cilat janë më të rëndësishmet prej tyre:

- 1) **Mungesa e profilizimit.** Nga një vështrim i shpejtë në burimet njerëzore të mediave shqiptare, dallon se në to mungojnë gazetarët e profilizuar në fushën e klimës. Sipas rastit, raportimet e kësaj fushe bëhen nga gazetarë të ekonomisë, të politikës, të aktualitetit apo të shkencës. Kjo fushë e dijes njerëzore dhe e gazetarisë kërkon njohuri, kompetenca dhe aftësi të cilat mund të zhvillohen përmes leximit dhe përvetësimit të literaturës si dhe përmes trajnimeve dhe veprimtarisë praktike.
- 2) **Kompleksiteti i çështjeve klimatike.** Në perceptimin e përditshëm të publikut, por edhe të një pjese të gazetarëve, çështjet e klimës janë të komplikuar dhe të vështira për t'u shpjeguar dhe kuptuar. Ka raste kur në media, ndryshimet klimatike përcillen në terma abstraktë apo në terma të cekët. Kjo bën që problemet të mbeten të distancuara nga realiteti i vërtetë dhe nga jeta e përditshme e njerëzve.
- 3) **Injorimi i çështjeve klimatike nga redaksitë apo politikat editoriale të mediave.** Në kohët e sotme, prirja për të tërhequr

vëmendjen e njerëzve i ka shtyrë mediat dhe pronarët e tyre drejt sensacionalizmit dhe klikimeve. Lajmet rozë, apo click-baits, mbizotërojnë axhendën e mediave duke shtyrë në periferi ato fusha raportimi që nuk sjellin klikime të shumta, siç është fusha e ndryshimeve klimatike.

- 4) **Vështirësia e aksesit tek të dhënat dhe burimet.** Ndryshimet klimatike shprehen edhe përmes një kategorie të gjërë të dhënash të cilat gjenden më së shumti në arkivat apo databazat e institucioneve shtetërore. Në çështje “të nxehta”, siç ka qënë së fundmi çështja e inceneratorëve në Shqipëri, aksesit tek të dhënat ka qënë i limituar ose i filtruar. Nga ana tjetër, neglizhenca dhe mungesa e politikave në këtë fushë ka sjellë situatën e mungesës së kërkimeve dhe të dhënave në këtë fushë. Po të hysh në databazat ndërkombëtare të të dhënave që lidhen me ndryshimet klimatike, të dhënat nga Shqipëria janë të pjesshme. Edhe INSTAT trashëgon një varfëri të theksuar të të dhënave në këtë fushë.

- 5) **Prania e censurës dhe e vetë-censurës.** Problemet që lidhen me ndryshimet klimatike shkaktohen shpesh prej politikave favorizuese ndaj bizneseve apo kompanive që çenojnë ekuilibrat klimatikë në emër të përfitimit monetar. Kompani të tilla si ato të inerteve, të karburanteve apo të industrisë së drurit kanë pushtet të mjaftueshëm për të ndërhyrë tek pronarët e mediave në mënyrë që ata të censurojnë raportimet që lidhen me dëmet që ato sjellin. Nga ana tjetër, ato gjejnë përkrahje edhe prej segmenteve të politikës dhe të vendimmarrjes shtetërore, të cilat krijojnë rregulla favorizuese për këta aktorë, ose shtyjnë në kohë hartimin dhe vënien në jetë të ligjeve kufizuese ndaj

tyre. Krahas mungesës së tematikave klimatike në axhendën e mediave, një situatë e tillë sjell edhe vetë-censurë në rradhët e gazetarëve.

- 6) *Mungesa e organizimit dhe e përfaqësimit.* Shqipëria është ndër vendet e pakta në Europë ku shoqatat e gazetarëve që merren me klimën mungojnë. Gjithashtu, janë shumë të rralla organizimet apo takimet profesionale për këtë fushë të rëndësishme të gazetarisë.
- 7) *Mungesa e trajnimeve.* Mungesa e një programi apo lënde shkollore në fushën e gazetarisë klimatike në Shqipëri, mund të kompensohej me ngritjen e kurseve të trajnimit. Inisiatorë në këtë drejtim mund të ishin vetë mediat, por edhe shkollat e gazetarisë apo organizatat e shoqërisë civile. Për fat të keq, përveç disa kontributeve të Institutit Shqiptar të Medias, iniciativat trajnuese mbeten të rralla

11

BURIME TË DOBISHME PËR GAZETARËT E KLIMËS

Gjatë dy dekadave të fundit ka patur një investim gjithnjë në rritje për të trajtuar dhe zgjidhur problemet e ndryshimeve klimatike. Kjo është shoqëruar me shtimin e numrit të institucioneve dhe organizatave që operojnë në këtë fushë. Për fat të mirë pjesa më e madhe e tyre mund të aksesohen online. Më poshtë po paraqesim një listë të burimeve kryesore që mund të përdoren nga gazetarët e klimës për të gjetur informacion si dhe shembuj të gazetarisë klimatike perëndimore.

11.1 Burime Vendore

Klima sot, <https://klima.al/>

Mjedisi, <https://mjedisi.al/>

Instituti Shqiptar i Medias, <https://www.institutemedia.org/>

Eco Albania, <https://www.ecoalbania.org/en/home19/>

EkoLëvizja, <https://ekolevizja.wordpress.com/gazetatarkiv/>

11.2 Burime ndërkombëtare

United Nations Climate Change, <https://unfccc.int/>

UNCC Learn, <https://www.uncclearn.org/>

REDD+ Web Platform, <https://redd.unfccc.int/>

Climate Funds Update, <https://climatefundsupdate.org/>

Climate Tracker, <https://climateactiontracker.org/>
Metcalf Institute for Marine & Environment Reporting, <https://metcalfinstitute.org/>
Poynter. News University, <https://www.poynter.org/newsu/>
The World Federation of Science Journalists, <https://wfsj.org/>
Society of Environmental Journalists, <https://www.sej.org/>
Earth Journalism Network, <https://earthjournalism.net/>
International Journalists Network, <https://ijnet.org/en>
Reuters AlertNet, <https://www.reuters.com/subjects/AlertNet>
Covering Climate Now, <https://coveringclimatenow.org/>
Climate News Network, <https://www.theenergymix.com/>
World Health Organization <http://www.who.int/>
Atlas of Climate Change and Health, <http://www.who.int/globalchange/publications/atlas/report/en/index.html>
SciDev.Net - Bringing science & development together through news & analysis. <http://www.scidev.net/global/>
Earth Journalism Toolkit: Communicating Risk. <http://earthjournalism.net/toolkit/?p=237>
YALE climate connections, <https://yaleclimateconnections.org/>
Nieman Lab, <https://www.niemanlab.org/>
Climate Communication, <https://climatecommunication.org/resources/#reports>
Climate Change Communication Research Hub, <https://www.monash.edu/mcccrh/people/john-cook>
Oxford Climate Journalism Network, <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/oxford-climate-journalism-network>
Earth Day 2022, <https://www.google.com/doodles/earth-day-2022>

REFERENCA

Artikuj

1. Ammons, S., Aja, H., & Ghazarian, A. A., et al. (2022). Perception of worry of harm from air pollution: Results from the Health Information National Trends Survey. *BMC Public Health*, 22 (1), 1254.
2. Brunet, N.D., Dagenais, D., Breux, S., & Handa, I.T. (2020). A characterization of media representation of biodiversity and implications for public perceptions and environmental policy: The case of Quebec, Canada. *Environment, Development and Sustainability*, 22, 1655- 1669.
3. Chiquier, S., Fajardy, M., & Mac Dowell, N. (2022). CO2 removal and 1.50C: What, where, when, and how? *Energy Advances*, 1, 524-561.
4. Cook, J., Oreskes, N., & Doran, P.T. (2016). Consensus on consensus: A synthesis of consensus estimates on human-caused global warming. *Environmental Research Letters*, 11, 048002.
5. El- Sayed, A., & Kamel, M. (2020). Climatic change and their role in emergency and re-emergence of diseases. *Environmental Science*, 27 (18), 22336-52.
6. Fisher, S.D., Kenny, J., & Poortinga, W., et al. (2022). The politicization of climate change attitudes in Europe. *Electoral Studies*, 79, 102499.
7. Malhi, Y., Franklin, J., & Seddon, N. (2020). Climate change and ecosystems: Threats, opportunities, and solutions. *Philosophical Transactions of the Royal Society of London*, 375, 20190104.
8. Parrish, R., Clobourn, T., & Lauriola, P. (2020). A critical analysis of the drivers of human migration patterns in the presence of climate change: A new conceptual model. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 19, 6036.
9. Poortinga, W., Whitmarsh, L., & Steg, L., et al. (2019). Climate change perceptions and their individual- level determinants: A cross European analysis. *Global Environmental Change*, 55, 25-35.
10. Qirjo, M. (2020). Ekologjia. Cikël prej 15 leksionesh.
11. Stefkovic, A., & Hortay, O. (2022). Fear of COVID-19 reinforces climate change beliefs.

- Evidence from 28 European countries. *Environmental Science & Policy*, 136, 717-725.
12. Tuitjer, L., & Dirksmeier, P. (2021). Social Media and perceived climate change efficacy. *Digital Geography and Society*, 2, 100018.

Raporte / manuale

1. Climate Analytics (2022). 1.50C Pathways for the EU27: Accelerating climate action to deliver the Paris Agreement. <https://climateanalytics.org/media/1-5pathwaysforeu27-2022.pdf>
2. EcoAlbania (2021). Hartëzimi i problematikës mjedisore përgjatë bregdetit në Shqipëri: Rast studimor: Qarku Vlorë, Durrës dhe Lezhë. https://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2022/02/01_Hartezimi-i-ceshtjeve-mjedisore-pergjate-bregdetit-ne-Shqiperi.pdf
3. Environmental Performance Index (2022). Ranking country performance on sustainability issues <https://epi.yale.edu/downloads/epi2022report06062022.pdf>
4. ICOMOS Climate Change and Heritage Working Group (2019). The future of our pasts: Engaging cultural heritage in climate action. Outline of Climate Change and Cultural Heritage. <https://www.icomos.org/en/focus/climate-change/60669-icomos-work-on-climate-change>
5. IPCC (2022). Sixth Assessment Report: Mitigation of Climate Change. https://www.ipcc.ch/report/ar6/wg3/downloads/report/IPCC_AR6_WGIII_Full_Report.pdf
6. Carbon Disclosure Project (2017). The Carbon Majors Database. <https://cdn.cdp.net/cdp-production/cms/reports/documents/000/002/327/original/Carbon-Majors-Report-2017.pdf?1501833772>
7. Nations Environment Programme Emissions Gap Report. 12th Report, 2021. Link <https://www.unep.org/resources/emissions-gap-report>
8. State of the World Birds. Birdlife International Report 2022. <https://www.birdlife.org/state-of-the-worlds-birds/>
9. Study on climate change in the Western Balkan Region, 2018 Link <https://www.rcc.int/pubs/62/study-on-climate-change-in-the-western-balkans-region>

10. Përshtatja në mënyrë aktive një ndër rrugët e zgjidhjes së krizës klimatike, Klima.al 2022. <https://klima.al/pershtatja-ne-menyre-aktive-nje-nder-rruget-e-zgjidhjes-se-krizes-klimatike/>
11. United States Environmental Protection Agency (2022). Climate change indicators: Ice Sheets. <https://www.epa.gov/climate-indicators/climate-change-indicators-ice-sheets>
12. Climate Change Strategy in Albania 2020-2030; Action Plan Monitoring 2019-2021, Link: https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/EN_Report_Monitoring%20of%20National%20Action%20Plan%20%281%29.pdf
13. Getting the Message Across - Reporting on Climate Change and Sustainable Development in Asia and the Pacific: A Handbook for Journalists; Link: https://en.unesco.org/sites/default/files/getting_the_message_across_climate_change_asia_pacific_web_2018.pdf
14. Climate-smart Reporting; A Handbook for Journalists and Communications Professionals
Link: <https://www.unclearn.org/wp-content/uploads/library/climatesmartreporting.pdf>

